




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____ Nr. Prot. _____
Dep. DPK Prot. No. 03-03/2058/18
Nr. I faq. _____ Data _____
Broj stranica _____ Datum 25.07.2018
Nr. pages 03 Date _____
PRISHTINE

DATË/A:	24.07.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1944/18
PËR/ZA/TO:	z. Mehmet RAMA, Menaxher i zyrës së Prokurimit - Komuna e Gllogocit
CC:	z. Ramiz LLADROVCI, Kryetar - Komuna e Gllogocit
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull “Ndërtimi i stadionit të qytetit-Faza e dytë (Projekt tre vjeçar)”



I nderuar z. Rama,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.01/2014 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull “Ndërtimi i stadionit të qytetit-Faza e dytë (Projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit 611/18/4347/511, nr. të brendshëm 611/18/065/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: “Ndërtimi i stadionit të qytetit-Faza e dytë (Projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit 611/18/4347/511, nr. të brendshëm 611/18/065/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 20 korrik 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1944/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i stadionit të qytetit-Faza e dytë (Projekt tre vjeçar)” me nr. të prokurimit: 611/18/4347/511, nr. të brendshëm: 611/18/065/511, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gllogocit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit punë, me vlerë të madhe të parashikuar 1,870,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që në njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: “*Lista e stafit profesional dhe teknik të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim: Emri, mbiemri, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni ne kompani dhe ka një mesatare në 3 (tri) vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë minimum 30 të punësuar të regjistruar në raportet e ATK-së. Në rast të grupit lideri duhet t'i ketë min. 15 punëtor*”, ndërsa tek dëshmia dokumentare është kërkuar: “*Lista e stafit (original dhe e vulosur) për personelin që do të jetë i angazhuar në këtë projekt. Të bashkangjitur me raportin nga ATK (mund të nxjerrë edhe nga ueb faqja e ATK-së) që dëshmon numrin që kompania ka një mesatare në 3 vitet e fundit minimum 30 të punësuar dhe që paraqitja e kontributeve të mos jetë më pak se 6 muaj për secilin punonjës dhe secilin vit*”. Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndeshë me nenin 69 paragrafi 6.4. të Ligjit në fuqi për Prokurimi Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga Autoriteti kontraktues është diskriminuese dhe nuk u mundëson operatorëve tjerë të cilët kanë një numër minimal të fuqisë punëtore të ofertojnë për këtë kontratë. Duke caktuar një kufizim të tillë autoriteti kontraktues favorizon vetëm operatorët ekonomik të cilët kanë minimum 30 të punësuar të regjistruar në raportet e ATK-së dhe i eliminon operatorët tjerë të cilët kanë një numër të kënaqshëm të të punësuarve.

Sipas nenit 69 paragrafi 6.4 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik, autoriteti kontraktues mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

Agjenci kunder Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

YES * OVO
"IT" *
XUSOVY